



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 31.

Prishtinë, më 07.12.2015 në orën 14:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Luljeta Veselaj- Gutaj, Vjosa Osmani, Arben Gashi, Kujtim Paçaku dhe Slllobodan Petroviq.

Munguan: Xhavit Haliti, Rrustem Mustafa, Ilir Deda, Valdete Bajrami dhe Time Kadrijaj

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky :

Rend i Ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhjet e datës: 02.11.2015, 03.11.2015 dhe 06.11.2015;
3. Shqyrtimi i Raportit të Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit;
4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-57 për themelimin e fondit Kosovar për garanci kreditore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-51 për treguesit gjeografik dhe për emërtimet e origjinës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-58 për dizajnin industrial, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-052 për energjinë termike, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

9. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
10. **Të ndryshme**

Kryetarja e Komisionit, Teuta Sahatqija, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen .

1. Miratimi i Rendit të ditës;

Para miratimit të rendit të ditës kryetarja kërkoj nga anëtarët e komisionit që të plotësohet edhe me dy pika tjera, Projektligji nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit L04/L042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04-/L-327 dhe Projektligjin nr.05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit i plotësuar dhe ndryshuar me ligjet nr.03/L-221, nr.04/L-116 dhe 04/L-194 sepse janë paraparë për seancë e radhës

Vjosa Osmani tha se duke pas parasysh që materiali iu është shpërndarë me vonesë dhe nuk kanë pas kohë ta lexojnë mendon se do të ishte më mirë të lihen për mbledhjen e radhës kur do të shqyrtohet buxheti dhe do të kemi kohë me i analizuar.

Arben Gashi po ashtu mendon se nuk duhet të plotësohet rendi i ditës me këto dy pika sepse janë ligje mjaft të ndjeshme dhe kërkojnë kohë për tu analizuar.

Kryetarja konstatoj se Rendi i ditës u miratua pa ndryshime dhe në mbledhjen e radhës kur do të shqyrtohet buxheti do të shqyrtohen edhe dy ligjet e sipërpërmendura .

2. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhjet e datës 02.11.2015, 03.11.2015 dhe 06.11.2015;

Kryetarja konstatoi se Procesverbalet nga mbledhjet e datës 02.11.2015, 03.11.2015 dhe 06.11.2015 u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit;

Kryetarja në vazhdim ia dha fjalën kryesueses së grupit punues që ta prezantoj raportin.

Luljeta Veselaj- Gutaj, Grupi punues gjatë monitorimit për zbatimin e ligjit në periudhën shkurt 2015 - nëntor 2015, ka realizuar këto vizita në terren, si Ministrinë e Punëve të Brendshme,¹ Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, strehimoren në Lipjan, dy organizata që merren me strehimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit, Këshillin Prokurorial, Këshillin Gjyqësor dhe ka organizuar një dëgjim publik me ato institucione që kanë të bëjnë me këtë ligj.

Bazuar në problemet e identifikuara, grupi punues, konkludon se Ligji nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, është i zbatueshëm me disa mangësi, për çka duhet të ndërmerren masa konkrete për ndryshim të gjendjes

Prandaj, me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të këtij ligji, grupi punues propozon rekomandimet si vijon:

1. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, të hartojë listën e treguesve lidhur me trafikimin me njerëz, me qëllim të lehtësimit të identifikimit të viktimave, në përputhje me nenin 12, paragrafi 2 i Ligjit nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.
2. Intensifikimi i takimeve dhe ngritja e bashkëpunimit të të gjithë përfaqësuesve në Autoritetin Kombëtar kundër Trafikimit me Njerëz dhe koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit me Njerëz.
3. Qeveria të vlerësojë mundësitë e ndarjes së një linje buxhetore për blerjen e shërbimeve për mbrojtjen e viktimave kundër trafikimit dhe dhunës.
4. Krijimi i një linje të veçantë buxhetore dhe të qëndrueshme, që ka të bëjë vetëm me mbrojtjen sociale të fëmijëve, duke përfshirë edhe financimin e strehimoreve që ofrojnë shërbime strehimi për fëmijë.
5. Krijimi i një linje buxhetore për ofrimin e shërbimeve ri-integruese afatgjate për fëmijët në nevojë, pasi që ata dalin nga strehimoret.
6. Organizatat që janë jofitimprurëse si strehimoret që kanë prona në emër të organizatës, të mos faturohen si biznese fitimprurëse, rekomandohet krijimi i një kategorie të veçantë për faturimin e strehimoreve.
7. Krijimi i një bashkëpunimi në mes nivelit komunal, strehimoreve dhe bizneseve private, për t'u dalë në ndihmë strehimoreve që akomodojnë viktimat të formave të ndryshme të krimit.

Rekomandim shtesë:

- Ministria e Punëve të Brendshme dhe koordinatori Kombëtar Kundër Trafikimit me Njerëz, do të raportojë për nivelin e zbatimit të ligjit, së paku, një herë në vit.²

Vjosa Osmani lidhur me raportin tha se meqenëse ligji ka të bëjë me parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni kaq negativ, mendon se disa rekomandime duhet të fokusohen në parandalim dhe luftim, sepse shumica e rekomandimeve përveç rekomandimit të dytë kanë të bëjnë me një gjendje pasi të ndodh trafikimi dhe si të ju ndihmojmë atyre, andaj kërkoj nga ata që kanë marr pjesë në ato takime se a është dhënë ndonjë vlerësim se sa ligji ofron masa parandaluse dhe masa të luftimit dhe nëse ka nevojë të ndryshohet diçka në at ligj që nuk ka lejuar që këto dy funksione të kryhen si duhet. Pra të ketë rekomandime që arrin ta parandalojë këtë fenomen ose ta luftoj para se të ndodh e jo të meremi me viktimat pasi të ndodh trafikimi.

Kurse çështja tjetër ka të bëjë me ndarjen e linjës buxhetore dhe rekomandimin numër 5 të ta shendojmë në amendament të komisionit për buxhet në mënyrë që të implementohet në praktikë.

Luljeta Veselaj- Gutaj theksoi se gjatë të gjitha takimeve që i kemi bërë nëpër institucione kemi diskutua edhe për pjesën e parandalimit dhe ne jemi njoftuar se ka fushatë sensibilizuese nëpër media dhe nëpër shkolla dhe janë përgatitur fletushka për me e parandalu këtë fenomen negativ. Por ne jemi mundu me nxjerr rekomandime për ato raste që veç kanë ndodhur dhe me i gjet mënyrat më të mirat të mundshme se mi i trajtua dhe

² Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, neni 73 (2).

riintegru në shoqëri. Kurse sa i përket rekomandimit të dytë për me bë amendament , tha se nuk është problem por mendoj se tani është vonë me ja dërgua komisionit për buxhet dhe pastaj nuk na votohet.

Vjosa Osmani shtoi dhe tha se është vonë për deputet individualisht kurse për komision mendoj jo.

Arben Gashi vlerësoi se dikush duhet ta bëjë edhe koston financiare për këtë amendament.

Kryetarja theksoi se pasi tani jemi vonë më mirë do të ishte që ky amendament të propozohet gjatë rishikimit të buxhetit.

Në fund të diskutimeve **Kryetarja** konstatoj se miratohet raporti i Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit;

4. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja tha se sa i përket këtij ligji ne kemi marr disa propozime nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike por në anën tjetër kjo fushë është përmendur disa herë edhe në Raportin e progresit, por megjithatë ne e kemi një ligj dhe i kemi amendamentet e komisionit funksional që e prekin një pjesë dhe jo të gjitha aspektet e analizuara në Raportin e Progresit. Lidhur me këtë hapi diskutimin.

Arben Gashi tha se ne e kemi përpara projektligjin për ndryshim dhe plotësim dhe nuk e di pse janë bërë ndryshimet përmbajtjesore këtu ,konkretisht amendamenti 6 dhe 8 që janë bërë në Ligjin bazik, dhe ne nuk mund ta bëjmë krahasimin se çka është bërë me këto amendamente pa e pas ligjin bazik dhe ata proceduralisht nuk kanë të drejt me bërë amendamente në ligjin bazik.

Kryetarja e lexoj opinionin ligjor për këtë projektligj, duke theksuar se projektligji përmban 15 nene dhe 7 amendamente të komisionit funksional dhe çështjet e rregulluara në këtë Projektligj nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë Projektligji së bashku me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohen për seancë.

Vjosa Osmani theksoi se ne përveç që ne secilin ligj e shikojmë nga aspekti i përputhshmërisë, ne duhet shikuar edhe se ligjet a përputhen me rrethanat e Kosovës , tani po shoh se neni 3 dhe 4 i përjashtojnë nga obligimet që dalin nga ky ligj këshilltarët dhe po ashtu thuhet nuk përfshihen personat që nuk kanë kompetenca vendimmarrëse , nuk më duket se ky model i ligjit është i mirë sepse e di vet kam punuar si këshilltare dhe e di çfarë ndikimi kanë në vendimet përfundimtare. Si është e mundur që në ligjin për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publik këshilltarët konsiderohen zyrtarë të lartë publik dhe duhet deklaruar pasurin kurse me këtë ligj nuk konsiderohen zyrtar të lart publik dhe kjo është një diskrepancë mes këtyre dy ligjeve .

Kryetarja ndërhyri dhe tha se neni 3 ,4 dhe 5 në amendamentet e komisionit funksional janë paraparë të hiqen .

Sllobodan Petroviç tha se nuk e kishte marr materialin dhe fillimisht nuk mund te votonte.

Vjosa Osmani tha se mbledhja e kaluar ka dështuar pikërisht sepse nuk na kanë ardhë emajlat edhe pse stafi i komisionit na i ka dërguar me kohë, problemi ka qenë në rrjetin e internetit sepse shumicës së deputetëve nuk ju kanë shkuar emajlat.

Kryetarja tha se përveç emajlave materiali gjendet edhe nëpër kutizat postare te secilit deputet dhe ftoheni edhe me telefon.

Pasi që u sqarua se ka pas probleme teknike ne përcjelljen emajlave dhe pasi Sllobodan Petroviç kërkoj pak koh ti analizoj amendamentet , Projektligji së bashku me amendamentet u hodh në votim.

Kryetarja pas votimit konstaton se Komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit Nr. 05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L- 051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së ,përkatesisht me “Acquis” të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në Kuvend

5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-57 për themelimin e fondit Kosovar për garanci kreditore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja fillimisht njoftoj se për pikat 5,6 dhe 7 ,Komisioni funksional e ka kërkuar mendimin tonë,por pasi mbledhja e kaluar nuk u mbajt për shkak të kuorumit,Komisioni funksional për zhvillim ekonomik i ka shqyrtuar këto pika edhe pa rekomandimin tonë ,por pavarësisht kësaj ne do ta dërgojmë rekomandimin për seancë plenare.

Në vazhdim prezantoj opinionin ligjor lidhur me përputhshmërin e Projektligjit me legjislacionin e BE-së. Projektligji i ka 27 nene dhe 24 amendamente.

Projektligji nr. 05/L-057 për themelimin e fondit Kosovar për garanci kreditore, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, pasi që janë shqyrtuar dhe analizuar, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatesisht me “Acquis” të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të mëtutjeshme në Kuvend.

Lidhur me këtë hapi debatin.

Kryetarja konstaton se komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 05/L-57 për themelimin e fondit Kosovar për garanci kreditore, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatesisht me “Acquis” të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të mëtutjeshme në Kuvend.

6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-51 për treguesit gjeografik dhe për emërtimet e origjinës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja prezantoi opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj duke theksuar se projektligji përmban 89 nene dhe 7 amendamente të komisionit funksional. Pas shqyrtimit është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Lidhur me këtë hapi diskutimin.

Kryetarja konstatoi se komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 05/L-51 për treguesit gjeografik dhe për emërtimet e origjinës, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me “Acquis” të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të mëtutjeshme në Kuvend.

7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-58 për dizajnin industrial, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja prezantoi opinionin ligjor për këtë projektligj dhe tha se Projektligji përmban 88 nene dhe 13 amendamente të komisionit funksional. Projektligji Nr. 05/L-058 për dizajnin industrial me amendamentet e Komisionit Funksional janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Lidhur me këtë hapi diskutimin.

Kryetarja konstatoi se komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 05/L-58 për dizajnin industrial, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me “Acquis” të BE-së,; prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të mëtutjeshme në Kuvend.

8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-052 për energjinë termike, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja lidhur me këtë projektligj prezantoi opinionin ligjor dhe tha se Projektligji përmban 38 nene dhe 28 amendamente të komisionit funksional.

Projektligji Nr. 05/L-052 për Energjinë Termike me amendamentet e Komisionit Funksional janë shqyrtuar dhe pasi është konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk është në kundërshtim me parimet e legjislacionit të BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së, mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Lidhur me këtë hapi diskutimin.

Kryetarja konstatoi se komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-052 për energjinë termike, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me “Acquis” të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të mëtutjeshme në Kuvend.

9. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetarja lexoj opinionin ligjor lidhur me projektligjin dhe tha se Projektligji përmban gjithsej 33 nene dhe 24 amendamente të komisionit funksional.

Konstatohet se Projektligji nr. 05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, pasi që janë shqyrtuar dhe analizuar, nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me “Acquis” të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të mëtutjeshme në Kuvend.

Lidhur me këtë projektligj hapi diskutimin .

Arben Gashi tha se pse është formuluar në gjuhën angleze amendamenti 1, kur e dimë se gjuhë zyrtare janë shqipja dhe serbishtja.

Vjosa Osmani pajtohet me vërejtjen e parafolësit dhe tha se ky amendament ish dashtë të hiqet sepse amendamentohet vetëm gjuha shqipe dhe serbe siç kërkohet me rregullore të Kuvendit dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe përveç kësaj është shkruar edhe gabim ish dashtë të shkruhet Law e jo Low.

Kryetarja tha atëherë lidhur me këtë amendament ne mund të japim vërejtje sepse gjuha zyrtare është gjuha shqipe dhe serbe dhe ky amendament të tërhiqet. Kurse sa i përket përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së konstatohet se Komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 05/L-38 për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, me amendamentet e Komisionit funksional nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht me “Acquis” të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të mëtutjeshme në Kuvend.

10. Të ndryshme

Kryetarja njoftoj lidhur me ftesën e dërguar nga BE-ja me të cilën ftohet Komisioni i Integritetit Evropian në Bruksel nga znj. Ulrike Lunaqek. Janë propozuar dy data, 14 dhjetori për të cilën znj. Lunaqek ka shkruar se kjo datë nuk është e përshtatshme sepse janë shumë të zënë sepse është java e fundit për festat e krshëndellave, prandaj 28 janari është datë e mundshme .

Vjosa Osmani tha se sot do të shqyrtohet Draft Rezoluta për Kosovën andaj duhet kërkuar që të na dërgojnë Rezolutën dhe të ju shpërndahet anëtarëve të Komisionit, sepse është një periudhë e komenteve para se të miratohet në komisionin për Politik të jashtme të Parlamentit Evropian dhe nëse kemi komente si komision apo individ të ja dërgojmë znj. Lunaqek.

Kryetarja si përfundim të mbledhjes tha se me pëlqimin e Komisionit dt. 28 janar u caktua për të shkruar në Bruksel dhe të kërkohet nga zyra e znj. Lunaqek të dërgohet draft Rezoluta për Kosovën dhe tu shpërndahet deputetëve të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Teuta Sahatqija